



VENDIMI I KUSHTETUESES: AVANTAZHE PËR DISA, ZGJIDHJE PËR ASKËND

FAQE 4-5



Rrëzimi i dekretit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për shpërndarjen e Kuvendit, shihet nga njohësit e fushës si një veprim që stabilizon në njëfarë mase institucionet, por lë të hapur krizën politike. Ata vlerësojnë se Kushtetuesja përdori një gjuhë të kujdesshme dhe të balancuar juridike në këtë rast. Sipas tyre, ky vendim u

jep institucioneve mundësi shtesë për të përmbushur detyrimet kushtetuese, përkatësisht për të bërë përpjekje të reja drejt zgjedhjes së presidentit

tucionet, por lë të hapur krizën politike. Ata vlerësojnë se Kushtetuesja përdori një gjuhë të kujdesshme dhe të balancuar juridike në këtë rast. Sipas tyre, ky vendim u

AKTUALE




TRUMPI E PARALAJMËRON IRANIN TË BËHET "SERIOZ", POR E ZGJAT AFATIN PËR NGUSHTICËN E HORMUZIT F. 2

HAXHIU: NEVOJITEN DISKUTIME SERIOZE PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT F. 5

NGA REZERVAT DERI TE TAKSAT: RRUGËT PËR STABILIZIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



ODA AMERIKANE DHE KUSARI-LILA DISKUTOJNË REFORMAT PËR PËRMIRËSIMIN E KLIMËS SË BIZNESIT F. 8

LDK-ja SHKON NË KEDS, DORËZON DËSHMI PËR MASHTRIMET ME NJEHSORËT ELEKTRIKË F. 8

SPORT



FIJORJA HISTORIKE E 'DARDANËVE', ADEMI: KOSOVA NUK DORËZOHET KURRË! F. 11



GIAUFRETI TAKON LIDERËT NË PRISHTINË, THEKSOHET THELLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KOSOVËS DHE BE-së F. 3



KOSOVA SHKRUAN HISTORI, KALON NË FINALE TË "PLAY-OFF"-it PËR BOTËRORIN 2026 F. 25

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI E PARALAJMËRON IRANIN TË BËHET “SERIOZ”, POR E ZGJAT AFATIN PËR NGUSHTICËN E HORMUZIT

UASHINGTON, 27 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka pezulluar për herë të dytë sulmet e mundshme ndaj centraleve energjetike të Iranit, duke i dhënë Teheranit edhe 10 ditë të tjera kohë për ta hapur Ngushticën e Hormuzit për transportin detar.

Trump tha të enjten vonë se bisedimet për përfundimin e luftës po shkojnë “shumë mirë”. Njoftimi i tij për shtyrjen e sulmeve të paralajmëruara erdhi pas një sërë paralajmërimesh publike se Irani duhet ta hapë rrugën ujore jetike dhe t’i përmbushë kushtet e SHBA-së “para se të jetë tepër vonë”. “Me kërkesë të Qeverisë iraniane... po e pezulloj periudhën e shkatërrimit të centraleve energjetike për 10 ditë, deri të hënën, 6 prill 2026, në orën 20:00, sipas kohës Lindore,” (02:00 më 7 prill sipas kohës evropiane) shkroi ai në platformën e tij, Truth Social.

Më 21 mars, Trump tha se Shtetet e Bashkuara do t’i “shkatërrojnë plotësisht” centralet energjetike të Iranit nëse Teherani nuk do ta hapte Ngushticën e Hormuzit brenda 48 orëve. Më vonë ai e zgjati afatin deri më 27 mars.

Ngushtica e Hormuzit është kanal kyç për transportin e naftës dhe gazit, të cilin Irani e ka bllokuar pothuajse plotësisht gjatë luftës me SHBA-në dhe Izraelin.

Zyrtarë të lartë iranianë e kanë mohuar se Teherani është në bisedime me Uashingtonin, por Irani tha më 25 mars se po shqyrtonte një propozim amerikan me 15 pika dhe paraqiti atë që i quajti pesë kushte që duhet të përmbushen për t’i dhënë fund konfliktit. “Bisedimet po zhvillohen dhe, pavarësisht deklaratave të pasakta nga mediat e rreme dhe të tjerë, ato po shkojnë shumë mirë”, tha Trump në postimin e 26 marsit në Truth Social.

Paraprakisht, Trump i bëri thirrje negociatorëve iranianë “të bëhen seriozë shumë shpejt” lidhur me bisedimet me Shtetet e Bashkuara për t’i dhënë fund luftës “para se të jetë shumë vonë”. “Ata po na ‘luten’ që të arrihet një marrëveshje, gjë që duhet ta bëjnë pasi janë shkatërruar ushtarakisht, kanë zero shans të rimëkëmben, dhe prapë publikisht deklarojnë se thjeshtë po ‘e shohin propozimin tonë’”, shkroi Trump në rrjetet sociale më 26 mars.

Deklaratat e tij vijnë një ditë pasi



Irani tha se po shqyrtonte planin e paqes prej 15 pikash të paraqitur nga SHBA-ja, që thotë se duhet të plotësohen pesë kushte në mënyrë që konflikti të përfundojë.

Detajet e planit amerikan nuk janë bërë publike, por mediat perëndimore kanë raportuar se propozimi përfshin disa nga kërkesat kyç të Uashingtonit që i ka pasur edhe para se të niste konflikti aktual përmes sulmeve ajrore të SHBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit më 28 shkurt. “Bëjnë mirë që të bëhen seriozë shumë shpejt, para se të jetë shumë vonë, sepse nëse ndodh kjo, nuk ka më kthim prapa dhe nuk do të jetë e bukur”, shtoi Trump.

Përdërisa plani raportohet se sugjeron çmontimin e ndërtesave bërthamore të Iranit, kufizimin e aftësive të tij raketore dhe përfundimin e mbështetjes për bashkëpunëtorët rajonalë, gjithashtu besohet se përfshin disa elementë të rinj, sikurse çështjet që ndërlidhen me Ngushticën e Hormuzit, e cila është pothuajse e mbyllur krejtësisht pasi Irani ka goditur disa anije.

Irani ka reaguar ashpër, duke thënë se kushtet amerikane janë të tepruara dhe se lufta do të marrë fund kur ai të vendosë se kur janë plotësuar kushtet e tij. Teherani insiston se ka të drejtë

të zhvillojë programin e raketave balistike dhe ka sovranitet mbi Ngushticën e Hormuzit.

Më 26 mars, një zyrtar i lartë iranian i ka thënë Reutersit se Teherani e sheh planin prej 15 pikave si plan që u shërben vetëm interesave të SHBA-së dhe Izraelit, duke e quajtur atë të “njëanshëm dhe të padrejtë”. Një ditë më parë, zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, u tha gazetarëve se kishte “elementë të vërtetësisë” në raportimet e mediave, por nuk konfirmoi ndonjë detaj.

Ajo gjithashtu sugjeroi se Trump do të konsideronte sulme më të gjera ndaj Iranit nëse Teherani dështon të “kuptojë se është mposhtur ushtarakisht”.

Më 26 mars, Axios citoi dy zyrtarë amerikanë dhe burime të tjera që thanë se ushtria amerikane po përgatit një gamë opsionesh për një “goditje të mundshme finale” kundër Iranit.

Sipas raportimit, skenarët e mundshëm përfshinin një invazion ose bllokadë të ishullit Harg, qendra kryesore e eksportit të naftës së Iranit, si dhe një invazion të ishullit Larak, i cili luan një rol kyç në kontrollin e Teheranit mbi Ngushticën e Hormuzit.

Si një rrugë kryesore për tranzitin e naftës dhe gazit,

Ngushtica e Hormuzit është bërë një çështje qendrore e luftës amerikano izraelite me Iranin. Trafiku detar në këtë rrugë - që është një arterie e rëndësishme për furnizimet globale me naftë dhe gaz - është pothuajse i ndalur për shkak të sulmeve iraniane mbi disa anije dhe kërcënimeve të mëtejshme nga Teherani.

Më 21 mars, presidenti Trump vendosi një afat 48-orësh për Iranin për të hapur Ngushticën e Hormuzit, por më pas e zgjati atë ditën tjetër për pesë ditë të tjera. Afati përfundon më 27 mars.

Gjatë një konference për media në Shtëpinë e Bardhë më 26 mars, Trump tha se besonte se Teherani po kërkonte negociata për shkak të “dhuratës” për SHBA-në, pasi tha se ka lejuar dhjetë cisterna nafte të kalojnë nëpër kornuz.

Teherani ka thënë se anijet nga vendet “joarmiqësore” do të kenë kalim të papenguar përmes Ngushticës së Hormuzit. Zyrtarët nuk kanë specifikuar se cilat vende përfshihen, megjithatë raportohet se anijet nga Malajzia dhe Pakistani janë lejuar të kalojnë.

Ndërkaq, Trump ka shtyrë aleatët e SHBA-së të ndihmojnë në hapjen e këtij rrjeti ujor jetik. Disa vende evropiane thanë se

ishin të gatshme të shqyrtonin ndihmën pasi të përfundonte konflikti, ndërsa të tjerat e refuzuan kërkesën, e cila erdhi pa asnjë specifikë.

Më 26 mars, Trump kritikoi aleatët e tij të NATO për mosndihmën ndaj SHBA-së, duke shtuar se “SHBA nuk ka nevojë për asgjë nga NATO.” “Shtetet e NATO-s nuk kanë bërë absolutisht asgjë për të ndihmuar me këtë komb të çmendur, tani ushtarakisht të shkatërruar, të Iranit”, shkroi ai. Gjatë një interviste për Fox News fundjavën e kaluar, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se kuptonte zemërimin e Trumpit, duke shtuar se aleanca po synon që të punojë në këtë çështje së bashku me Japoninë, Korenë e Jugut, Australinë, Zelandën e Re, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahrejin.

Gjatë fjalës së tij vjetore më 26 mars, Rutte nuk përmendi Ngushticën e Hormuzit, por paralajmëroi për lidhjet e Iranit me Rusinë.

Ai po ashtu përsëriti se dërgesat e armëve amerikane për Ukrainën, të paguara nga aleatët evropianë të Kievit, janë “kritike”, pasi vëmendja globale ka kaluar në mënyrë të konsiderueshme nga pushtimi rusi i Ukrainës, drejt konfliktit në Lindjen e Mesme.

KURTI NË FRANCË, VUÇIQ PRETENDON SE KRYEMINISTRI MUND TË KËRKOJË “SHKUARJEN E FSK-SË” NË VERI

PRISHTINË, 27 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar të premten për vizitë zyrtare në Francë, ku pritet të takohet me presidentin Emmanuel Macron. Qeveria e Kosovës nuk ka dhënë më shumë hollësi rreth këtij takimi.

Por, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka pretenduar të enjten mbrëma në televizionin Prva në Beograd, se kryeministri Kurti mund t'i kërkojë liderit francez plotësimin e ca kushteve “kundër popullit serb”.

Sipas presidentit serb, Kurti ka shkuar në Paris me “dy kërkesa”: që Serbisë t'i vendoset kusht për të mos përdorur kurrë armë kundër shqiptarëve, përkatësisht kundër Kosovës, dhe që NATO-ja të largohet nga zona tokësore e sigurisë, në mënyrë që Forca e Sigurisë së Kosovës të mund të shkojë në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe.

Vuçiq pretendon se “agjendën e Kurtit në Paris” e ka mësuar përmes “njerëzve tanë në rrethin e Kurtit”.

Mes tjerash, Vuçiq ka thënë se shpreson që NATO-ja “nuk do t'i mbështesë këto kërkesa dhe jam i sigurt që as Macron nuk do t'i mbështesë”. “Ky do të ishte sulm i

drejtpërdrejtë ndaj paqes, sulm i drejtpërdrejtë ndaj popullsisë sonë, ndaj gjithë Serbisë, dhe jam pothuajse i sigurt se kjo nuk do të ndodhë”, tha Vuçiq.

Radio Evropa e Lirë e ka pyetur Qeverinë e Kosovës për qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e Vuçiqit, por nuk ka marrë ende përgjigje.

Shqetësimet e Kosovës për armatosjen e Serbisë dhe veriu

Pretendimet e Vuçiqit vijnë në një kohë kur autoritetet kosovare kanë shprehur shqetësim pasi Serbia bleu raketat balistike supersonike CM-400 nga Kina në fillim të muajit.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, i tha Radios Evropa e Lirë më 13 mars se Serbia, përmes këtyre blerjeve, po shfaq “tendenca hegjemoniste” karshi vendeve fqinje.

Rreth një javë më vonë, Kurti e akuzoi Beogradin për shfaqje të “agresionit” pasi ushtria serbe kreu stërvitje më 19 mars në një fshat të banuar me shqiptarë etnikë në jug të Serbisë, në kufi me Kosovën.

Ai tha asokohe se “jemi thellësisht të shqetësuar me demonstrimin e



pajustificueshëm ushtarak të Serbisë, me helikopterë e parashutistë, në zonat e banuara me shqiptarë në Bujanoc, fare pranë kufirit me Kosovën”.

Por, misioni i NATO-s në Kosovë, i tha Radios Evropa e Lirë se ato stërvitjet nuk përbënin rrezik dhe se ishte njoftuar paraprakisht nga Beogradi se Forcat e Armatosura të Serbisë do të zhvillonin stërvitje të planifikuara në fshatin Muhovc, pranë kufirit jugor të Kosovës.

KFOR-i është përgjegjës për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë, ndërsa për pjesën tjetër

të vijës kufitare është Policia e Kosovës.

Kosova dhe Serbia ndajnë një vijë kufitare të gjatë rreth 400 kilometra.

Forca e Sigurisë së Kosovës, FSK, nuk ka të drejtë të shkojë në veriun e banuar me shumicë serbe, pa e marrë pëlqimin paraprak të misionit paqeruajtës të NATO-s, bazuar në zotimin e vitit 2013 nga Qeveria e Kosovës ndaj NATO-s.

Ky angazhim, i dhënë përmes një letre nga ish-kryeministri Hashim Thaçi drejtuar sekretarit të

atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, mbetet në fuqi edhe sot, pavarësisht ndryshimeve në mandatin e FSK-së.

Hera e fundit kur FSK-ja ishte në veri, me pëlqimin e KFOR-it, ishte më 29 korrik të vitit 2025, në një operacion kur gjeti trupin e pajetë të një personi që kishte kërcyer nga ura në liqenin e Ujmanit.

FSK-ja është në proces të shndërrimit në ushtri, pas ndryshimeve ligjore të miratuara. Ky proces pritet të përmbyllet më 2028.

EMISARI I BE-së TAKON LIDERËT NË PRISHTINË, THEKSOHET THELLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KOSOVËS DHE BE-së

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka pritur një delegacion nga Bashkimi Evropian të kryesuar nga Emanuele Giaufret, zëvendësdejtërin menaxhues të EEAS-it për Evropën Perëndimore.

Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet aktuale politike dhe ekonomike në vend, si dhe për rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Hamza mirëpriti vëmendjen e rikthyer të BE-së ndaj Kosovës dhe rajonit, si dhe vendimin për heqjen e masave, duke e vlerësuar këtë si një hap pozitiv për forcimin e partneritetit dhe perspektivës evropiane të vendit.

Ai theksoi se një Kosovë stabile dhe një rajon stabil janë në interes të përbashkët të të gjithë popujve të Ballkanit Perëndimor dhe të vetë Bashkimit Evropian.

Hamza rikonfirmoi përkushtimin e PDK-së për bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë dhe theksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme të BE-së për Kosovën, veçanërisht në përballimin e sfidave ekonomike dhe avancimin e reformave.

Në takim u ritheksua se aspirata strategjike e Kosovës mbetet integrimi në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO, si një orientim i qartë drejt zhvillimit, stabilitetit dhe integritetit të plotë euroatlantik.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim Emanuele Giaufret. Gjatë këtij



takimi, kryetari Abdixhiku diskutoi për qëndrimin e LDK-së për zhvillimet politike aktuale në vend, me theks të veçantë mbi situatën e krijuar rreth çështjes së zgjedhjes së presidentit të Republikës dhe rolin e institucioneve të Kosovës në këtë proces.

Ai nënvizoi se përgjegjësia kryesore për përmbylljen e këtij

procesi i takon shumicës parlamentare, duke shprehur bindjen se ky proces duhet të zgjidhet përmes një marrëveshjeje politike dhe jo me imponim.

Në lidhje me mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të reja, Abdixhiku theksoi se Lidhja Demokratike e Kosovës do të hyjë e bashkuar dhe e përgatitur në çdo proces zgjedhor, duke besuar se ka

mundësinë për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme dhe zhvillimore për vendin.

Po ashtu, Abdixhiku shprehu mirënjohjen e LDK-së për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian ia ka ofruar Kosovës gjatë të gjitha proceseve, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm të BE-së në forcimin e stabilitetit, demokracisë dhe orientimit evropian të vendit.

Ai theksoi nevojën për thellimin e bashkëpunimit dypalësh, veçanërisht në fushat e ekonomisë, zhvillimit dhe integritetit evropian, duke e konsideruar këtë si një hap thelbësor në rrugëtimin e Kosovës drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe më të mirë për qytetarët tanë.

Po ashtu Giaufret, është pritur në takim edhe nga kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Ky i fundit ka bërë me dije se diskutuan për zhvillimet aktuale politike në vend e rajon, proceset integruese euroatlantike dhe rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit me Bashkimin Evropian.

“Theksova përkushtimin e Aleancës për avancimin e agjendës evropiane të vendit.

Kosova gjatë këtyre viteve ka ngecur në agjendën integruese euro-atlantike, veçanërisht në synimin për anëtarësim në NATO dhe Bashkimin Evropian, është jetike që ta kthejmë vendin në binarë të sigurt, përmes vendimmarrjes së përgjegjshme dhe forcimit të partneritetit me aleatët tanë”, ka thënë Haradinaj.





VENDIMI I KUSHTETUESES: AVANTAZHE PËR DISA, ZGJIDHJE PËR ASKËND

Rrëzimi i dekretit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për shpërndarjen e Kuvendit, shihet nga njohësit e fushës si një veprim që stabilizon në njëfarë mase institucionet, por lë të hapur krizën politike. Ata vlerësojnë se Kushtetuesja përdori një gjuhë të kujdesshme dhe të balancuar juridike në këtë rast. Sipas tyre, ky vendim u jep institucioneve mundësi shtesë për të përmbushur detyrimet kushtetuese, përkatësisht për të bërë përpjekje të reja drejt zgjedhjes së presidentit.

PRISHTINË, 27 MARS - Në një moment të ndjeshëm politik, kur Kosova rrezikonte të hynte në një spirale të re pasigurie institucionale, Gjykata Kushtetuese nxori një vendim që riktheu balancën formale kushtetuese, por jo domosdoshmërisht edhe zgjidhjen politike. Rrëzimi i dekretit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për shpërndarjen e Kuvendit, shihet nga njohësit e fushës si një veprim që stabilizon në njëfarë mase institucionet, por lë të hapur krizën politike.

Më 25 mars, Gjykata Kushtetuese konstatoi se dekreti i presidentes “nuk ka efekt juridik” dhe i dha Kuvendit një afat prej 34 ditësh për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit - në të kundërtën, Kuvendi do të shpërndahet. Presidenti i Kosovës zgjidhet nga Kuvendi përmes tri raundeve votimi që kërkojnë kuorum dhe shumicë të caktuar, duke e bërë procesin kryesisht të varur nga arritja e kompromisit politik ndërmjet partive. Nëse ky proces dështon brenda afateve të përcaktuara me

Kushtetutë, vendi shkon në zgjedhje.

Si arriti çështja në Kushtetuese?

Osmani nxori dekretin për shpërndarjen e Kuvendit më 6 mars, një ditë pasi institucioni ligjvënës nuk arriti të zgjidhte presidentin e ri, edhe pse procedurën e nisi. Masa e saj u kontestua në Gjykatën Kushtetuese nga Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti. Si rezultat, Kushtetuesja vendosi masë të përkohshme, duke pezulluar çdo veprim të institucioneve deri në vendimin përfundimtar, që u publikua më 25 mars. Vullnet Bugaqku, nga Instituti Demokratik i Kosovës, vlerëson se Kushtetuesja përdori një gjuhë të kujdesshme dhe të balancuar juridike në këtë rast. Sipas tij, vendimi karakterizohet nga një ton neutral interpretues, por nuk i shmanget ndikimit të kontekstit aktual politik. “Interpretimi kushtetues dhe

juridik i këtij dekreti është bërë kryesisht në kontekstin e ngërçit politik aktual. Gjykata e ka një paragraf ku thotë se interpretimi i dispozitave kushtetuese lidhet me rrethanat politike në vend, dhe kjo përbën një nga dobësitë e aktgjykimit”, thekson Bugaqku për Radion Evropa e Lirë. Ai shton se vendimi, megjithatë, u jep institucioneve mundësi shtesë për të përmbushur detyrimet kushtetuese, përkatësisht për të bërë përpjekje të reja drejt zgjedhjes së presidentit. Në të njëjtën linjë, por me një ton më kritik, analisti Rrahman Paçarizi, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, e konsideron vendimin e Kushtetueses si një vlerësim neutral, por jo domosdoshmërisht profesional. Sipas tij, Gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat politike, duke shkuar “përtej interpretimit të ftohtë profesional të Kushtetutës”. “Sigurisht që dikujt i ka krijuar disa avantazhe, dikujt tjetër më

pak. Por, ka qenë një përpjekje që ‘edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet’”, thotë Paçarizi për Radion Evropa e Lirë.

Kush përfiton nga vendimi?

Sipas Bugaqkut, përfitues kryesorë janë vetë institucionet dhe rendi kushtetues. “Fitues realë janë institucionet - Kushtetuta dhe Kuvendi. Gjykata e riktheu në binarë kushtetutshmërinë e mandatit të Kuvendit dhe legjitimitetin e përfaqësuesve të qytetarëve, duke konstatuar se dekreti nuk prodhon asnjë efekt juridik”, thotë ai. Paçarizi, nga ana tjetër, vëren se në opinion ekziston perceptimi se vendimi i ka krijuar avantazhe Lëvizjes Vetëvendosje. Por, ai nuk sheh përfitime konkrete politike për këtë subjekt, përveç mundësisë për të ndërtuar një narrativ politik. “Reagimet e Vetëvendosjes u fokusuan te rrëzimi i dekretit të presidentes, jo te gjetja e një zgjidhjeje për

HAXHIU: NEVOJITEN DISKUTIME SERIOZE PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se nevojiten diskutime serioze nëse partitë duan që përnjëmend ta zgjedhin presidentin e ri të shtetit.

Haxhiu, që vjen nga radhët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, tha se vendi nuk ka nevojë të shkojë në zgjedhje sepse qytetarët kanë mbajtur votime në dhjetor. “Nevojiten diskutime serioze nëse duam apo nuk duam përnjëmend ta zgjedhim presidentin. Për faktin se është e rëndësishme që ajo që thuhet në takime të mbyllura të jetë qëndrim real dhe jo vetëm diskutim sa për të thënë”, tha Haxhiu për mediet më 27 mars. Më 25 mars, Gjykata Kushtetuese publikoi një aktgjykim, duke u thënë deputetëve se kanë edhe 34 ditë kohë për ta zgjedhur presidentin e ri, përkatësisht deri më 28 prill, në të kundërtën vendi shkon automatikisht në zgjedhje.

Çështja u dërgua në Kushtetuese nga Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Albin Kurti, pasi më 6 mars, presidentja e vendit, Vjosa Osmani, nxori një dekret për shpërndarjen e Kuvendit, një ditë pasi deputetët dështuan të zgjidhnin paraardhësin e Osmanit. Kushtetuesja gjeti se dekreti i Osmanit nuk ka prodhuar ndonjë efekt juridik. Kryeparlamentarja Haxhiu tha se seanca e 5 marsit nuk është mbyllur dhe ajo do të vazhdojë “sapo të krijohen kushtet”.

Haxhiu tha se kryeministri Kurti, njëherësh kreu i LV-së, veçse ka kërkuar takime me subjektet opozitare.

Kurti u dërgoi ftesa krerëve të



Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike në kohën kur ende nuk ishte publikuar aktgjykimi. Të dy partitë u shprehën të gatshme për takim pas aktgjykimit, por që nga publikimi i aktgjykimit nuk është paralajmëruar ndonjë takim. “Natyrshisht që kërkesat për takime do të vazhdojnë, por në anën tjetër nevojitet edhe vullneti i palës tjetër. Grupi parlamentar i Vetëvendosjes më së shumti i ka 66 vota, por kjo është e pamjaftueshme për ta zgjedhur presidentin e vendit sepse nevojiten 80 vota në kuti të paktën në dy rundet e para. Në këtë pikë mendoj që është shumë i rëndësishëm kontributi i të gjitha palëve, por kontributi të jetë serioz sepse mendoj që

pajtohemi që vendi nuk ka nevojë për zgjedhje të reja sepse zgjedhjet sapo i kemi përfunduar, qytetarët kanë folur, kanë dhënë mesazhin e tyre, prandaj kemi shumë punë për të bërë”, tha Haxhiu.

Më 5 mars, LV-ja propozoi dy kandidatë për president, zëvendëskryeministrin, njëherësh kryediplomatën e Kosovës, Glauk Konjufcën, dhe deputeten Fatmire Kollçaku. Megjithatë, emrat e tyre nuk u hodhën në votim, pasi nuk kishte kuorum.

Në aktgjykimin e saj, gjykata më e lartë në vend tha se Kuvendi i Kosovës shpërndahet në tri raste: nëse brenda 60 ditësh nga data e caktimit të mandatarit nga presidenti nuk formohet

Qeveria, nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë 2/3 e të gjithë deputetëve dhe nëse brenda 60 ditësh nga data e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjidhet presidenti i Kosovës. “Gjykata marrë për bazë kontekstin specifik të rrethanave të konstituimit të Kuvendit më 11 shkurt 2026, vlerësoi se Kuvendi nuk ka pasur gjashtëdhjetë 60 ditë në dispozicion, brenda të cilës periudhë duhej përfunduar procedura për zgjedhjen e presidentit”, u tha në vendim të Kushtetueses.

Sipas Gjykatës Kushtetuese procedura për zgjedhjen e presidentit, “që nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë”, duhet të përfundojë “jo më vonë

se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual”. “Këto dy afate janë të ndërlidhura, në atë mënyrë që procedura duhet të zhvillohet brenda kufirit prej 60 ditësh dhe të përfundojë me zgjedhjen e presidentit jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual”, u tha në vendim.

Pas aktgjykimit, LV-ja tha se ky moment duhet të shfrytëzohet “për reflektim dhe për angazhim të të zgjedhurve të popullit, në mënyrë që vendi të mos futet në një krizë të re dhe në një cikël të përsëritur zgjedhjesh”.

Nga PDK-ja thanë se e respektojnë vendimin dhe në ditët në vijim do të bëjnë publikë vendimet politike që do të ndërmarrin.

Kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, tha se përgjegjësia kryesore për zgjedhjen e presidentit bie mbi LV-në, duke shtuar se për këtë çështje duhet marrëveshje politike mes partive.

Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mundë të mbahet.

Presidentja aktuale, Vjosa Osmani, përfundon mandatin e saj pesëvjeçar në krye të shtetit më 5 prill.

Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo ajo nuk gëzoi mbështetjen e partive.

Për partinë në pushtet, ajo nuk i kishte votat e nevojshme, ndërsa për partitë e tjera ajo nuk e ka personifikuar unitetin e nevojshëm që i duhet figurës së presidentit.

Betohen nëntë anëtarët e rinj të KQZ-së

PRISHTINË, 27 MARS - Anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të propozuar nga partitë politike të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të premtën e kanë dhënë betimin para Presidentes së

Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Presidentja Osmani u uroi suksese anëtarëve të rinj, duke vlerësuar faktin se sistemi jonë zgjedhor gjithmonë i ka kontribuar demokracisë në vend.

Në anën tjetër, anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u betuan se do t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të ndershme, besnike, të paanashme, profesionale dhe të ndërgjegjshme.



krizën. Askush, as nga pushteti e as nga opozita, nuk foli për krijimin e kushteve për të shmangur zgjedhjet”, thekson ai.

Pa fitues real, drejt zgjedhjeve?

Pavarësisht efektit stabilizues në planin institucional, analistët vlerësojnë se vendimi nuk ka prodhuar zgjidhje politike. Paçarizi thekson se mungesa e vullnetit politik për konsensus mes partive e bën të pamundur që ky vendim të shërbejë si pikë kthese. “Nuk ka një fitues real”, thotë ai, “vendimi nuk krijon kushte për konsolidimin e

vullnetit politik për zgjedhjen e presidentit”.

Sipas Paçarizit, vendi tashmë duket se po shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe vendimi i Kushtetueses mund të përdoret nga partitë vetëm si instrument në fushatat e tyre. “Përfitimi i vetëm është mundësia që secila palë të shfrytëzojë elemente të aktgjykimit për të ndërtuar narrativët e vet parazgjedhorë”, shton ai, duke mbetur skeptik për mundësinë që brenda afatit 34-ditor të ndryshojë dinamika politike. “Duket se të gjitha partive politike u pëlqen shkuarja në zgjedhje”, thotë Paçarizi.

Reagimet e partive: Përgjegjësia mbetet te konsensusi politik

Situata e krijuar pas vendimit të Kushtetueses nxiti reagime të ndryshme nga përfaqësuesit e partive politike në Kosovë.

Arbërie Nagavci, nga Lëvizja Vetëvendosje në pushtet, tha se ky moment duhet të shfrytëzohet “për reflektim dhe për angazhim të të zgjedhurve të popullit, në mënyrë që vendi të mos futet në një krizë të re dhe në një cikël të përsëritur zgjedhjesh”.

Kreu i Partisë Demokratike të

Kosovës në opozitë, Bedri Hamza, tha para mbledhjes së Kryesisë së partisë të enjten, se pas vendimit të Kushtetueses nuk kishte marrë ndonjë ftesë nga kryeministri Albin Kurti për të diskutuar rreth zgjedhjes së presidentit.

Ndërkaq, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, theksoi se përgjegjësia kryesore për zgjedhjen e presidentit mbetet te shumica parlamentare, përkatësisht Lëvizja Vetëvendosje.

Ai shtoi se asgjë nuk mund të zgjidhet me imponim, por vetëm “me marrëveshje politike

ndërmjet forcave përfaqësuese” dhe nëse kjo mungon brenda afatit 34-ditor, LDK-ja “do të hyjë e bashkuar dhe e përgatitur në çdo proces të ri zgjedhor”.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës paralajmëroi mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm të partisë “për të diskutuar zhvillimet aktuale politike në vend dhe qëndrimet e Aleancës lidhur me situatën e krijuar” pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Pas vendimit, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka ftuar mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për të hënë, më 30 mars.

STUDENTËT E INOVACIONIT, INTELIGJENCËS ARTIFICIALE DHE DIGJITALIZIMIT PËRBËJNË NJË SHTYLLË TË RËNDËSISHME TË MBROJTJES, KRAHAS FSK-SË



Shkruan:
Safet GËRXHALIU

FSK-ja në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, mbetet garancia kryesore e mbrojtjes së lirisë dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës - një arritje që na bën të gjithëve krenarë. Megjithatë, në realitetin e ri global, siguria nuk

ndërtohet më vetëm me kapacitete tradicionale ushtarake, por gjithnjë e më shumë me dije, teknologji dhe inovacion.

Në këtë kontekst, “ushtria e së ardhmes” e Kosovës nuk është vetëm FSK-ja, por edhe të rinjtë tanë - studentë, inovatorë dhe sipërmarrës që zhvillojnë ide në universitete, kolegje dhe sidomos në ekosistemin në rritje të start-up-eve.

Fushat si Teknologjia e Informacionit, Mekatronika, Elektronika, Digjitalizimi dhe Inteligenca Artificiale janë tashmë kritike jo vetëm për zhvillim ekonomik, por edhe për sigurinë kombëtare.

Doktrinat moderne të mbrojtjes kanë evoluar ndjeshëm, duke u përshtatur me revolucionin teknologjik. Konfliktet e fundit globale dëshmojnë qartë se epërsia nuk përcaktohet vetëm nga numri i ushtarëve, por nga superioriteti teknologjik dhe inovativ. Përdorimi i dronëve, sistemeve autonome dhe raketave të drejtuara me inteligjencë artificiale ka ndryshuar rrënjësisht natyrën e luftës, duke e bërë teknologjinë faktor vendimtar.

Në këtë kuadër, Kosova ka një avantazh strategjik: popullatën e re dhe potencialin e madh njerëzor. Por ky potencial duhet të shndërrohet në kapital

zhvillimor dhe mbrojtës përmes investimeve të qëndrueshme dhe të mirë-orientuara. Kjo nënkupton: Rritjen e investimeve publike dhe private në kërkim-zhvillim (R&D); Mbështetje konkrete për start-up-et teknologjike, veçanërisht ato që zhvillojnë zgjidhje në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes; Krijimin e fondeve të veçanta për inovacion në sektorin e “defense-tech”; Ndërlidhjen më të fortë mes universiteteve, sektorit privat dhe institucioneve të sigurisë; Mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe ideve inovative të të rinjve.

Inovatorët dhe ndërmarrësit e rinj duhet të shihen si aset

strategjik kombëtar. Ata nuk janë vetëm kontribuues në ekonomi, por edhe faktorë kyç në ndërtimin e një sistemi të avancuar të sigurisë. Përmes ideve të tyre, ata mund të zhvillojnë teknologji që jo vetëm rrisin konkurrueshmërinë ekonomike, por edhe forcojnë kapacitetet mbrojtëse të vendit. Në fund të fundit, një Kosovë e sigurt është një Kosovë që investon në dije, inovacion dhe sipërmarrje. Duke mbështetur të rinjtë në këto fusha, ne nuk po ndërtojmë vetëm një ekonomi moderne, por edhe një “ushtri të heshtur” të së ardhmes - të pajisur me dije, kreativitet dhe teknologji të avancuar.

SULM KIBERNETIK NDAJ POSTËS SHQIPTARE

TIRANË, 27 MARS - Posta Shqiptare është goditur nga një sulm kibernetik që ka prekur infrastrukturën e teknologjisë së informacionit të Postës, tha Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në Shqipëri.

Sipas autoriteteve, sulmi është kryer mbrëmjen e së mërkurës. Ai nuk ka shkaktuar ndërprerje të shërbimeve të Postës Shqiptare si dhe nuk janë fshirë të dhënat.

Ky është sulmi i dytë kibernetik, në pak ditë, ndaj institucioneve në Shqipëri. Më 10 mars Kuvendi i Shqipërisë u godit nga një sulm kibernetik, si pasojë e të cilit u fshinë një pjesë e të dhënave në disa llogari përdoruesish të punonjësve të administratës.

Për të dy sulmet përgjegjësinë e ka marrë Homeland Justice, e cila është faqe e internetit me shtrirje ruse që u shfaq para sulmeve kibernetike në portalin shtetëror e-Albania, në mes të korrikut të vitit 2022. Sipas analizës së Microsoft, pas kësaj faqeje qëndron një grup i lidhur me Qeverinë iraniane. “Posta Shqiptare u sulmua nga patriotët e Homeland Justice për shkak të bashkëpunimit të vazhdueshëm me terroristët Organizatës Popullore Muxhahedine të Iranit [MEK] dhe për lehtësimin e rrugës së veprimeve të këqija dhe akteve terroriste të këtij grupi”, thuhet në llogarinë në Telegram të këtij grupi.



Në Shqipëri, prej vitesh strehohet grupi opozitar iranian Mojahedin-e-Khalq (MEK).

Grupi Homeland Justice po ashtu paralajmëroi se veprimet e ardhshme do të jenë më të ashpra.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në Shqipëri deklaroi se pas sulmit ndaj Postës një grup ekspertësh ka nisur punën për analizimin e incidentit dhe verifikimin e çdo komprometimi të mundshëm si dhe izolimin dhe sigurimin e sistemeve, me qëllim parandalimin e çdo ndikimi të mëtejshëm.

Për këtë arsye disa shërbime janë

vendosur përkohësisht jashtë funksioni nga vetë Posta Shqiptare. “Janë publikuar disa të dhëna të dyshuara si të eksfiltruara, të cilat po verifikohen për autenticitetin dhe burimin e tyre. Deri në këtë moment, sasia e të dhënave të mundshme të ekspozuara vlerësohet e kufizuar”, theksoi autoriteti. Më 20 mars Shtetet e Bashkuara njoftuan se kishin ndërmarrë një operacion të rëndësishëm kundër infrastrukturës kibernetike të lidhur me Iranin, duke sekuestruar katër faqe interneti të përdorura për sulme dhe operacione psikologjike.

Autoritetet amerikane konfirmuan se dy nga domenet e sekuestruara - Justicehomeland[.]org dhe Karmabelow80[.]org - janë përdorur për të publikuar dokumente të vjedhura nga institucionet shtetërore shqiptare.

Që nga viti 2022, Shqipëria e ka akuzuar Iranin për kryerjen e një serie sulmesh shkatërruese kibernetike të cilat patën në shënjestër infrastrukturën digjitale shtetërore dhe shërbimet publike, dhe çuan në ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike mes Tiranës dhe Teheranit.

Kush është MEK-u?

MEK-u e konsideron veten lëvizje opozitare në mërgim kundër regjimit klerikal të Iranit. I themeluar si grup marksist kundër shahut, ai mbështeti Revolucionin e vitit 1979, por më pas u përplas me regjimin islamik, duke kryer atentate dhe sulme me bomba.

Për vite ishte në listën amerikane të organizatave terroriste, derisa u hoq në vitin 2013. Po atë vit, me ndërmjetësim të SHBA-së dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, anëtarët e tij u zhvendosën nga Iraku në Shqipëri, ku ndërtuan kampin “Ashraf-3”, pranë Durrësit.

Më shumë mund të lexoni këtu. Por, kjo lëvizje nuk gëzon përkrahje popullore në Iran. Përfshirja e saj në një seri aktesh të dhunshme në vitet 1970 dhe 1980 në Iran, dhe vendimi i saj për të mbajtur anën e Irakut gjatë Luftës së përgjakshme Iran-Irak të viteve 1980-88, çoi në etiketimin e pjesëtarëve të grupit si tradhtarë në mesin e iranianëve. Megjithatë, qëndrimi i MEK-ut në Shqipëri nuk ka kaluar pa probleme.

Më 20 qershor të vitit 2023, Policia e Shtetit shqiptar bastisi kampin e MEK-ut, nën dyshimet se disa pjesëtarë të tij kanë kryer veprat penale “provokim i luftës” dhe “sulme kibernetike”. Vetë MEK-u e cilësoi aksionin policor si “kriminal” dhe “shtypës”.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, në periudhën dyjavore, përfundon 307 lëndë

PRISHTINË, 27 MARS - Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës dyjavore nga data 13.03.2026 deri më datë 27.03.2026, ka realizuar një angazhim të vazhdueshëm në trajtimin e

lëndëve penale.

Gjatë kësaj periudhe, kjo Prokurori ka pranuar gjithsej 457 lëndë të reja, ndërsa ka përfunduar gjithsej 307 lëndë, duke përfshirë të gjitha natyrat e çështjeve në

përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në kuadër të numrit të përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura, Prokuroria Themelore në Prishtinë për këtë periudhë kohore ka

ngritur 95 aktakuza kundër 113 personave, si rezultat i punës intensive dhe hetimeve të zhvilluara me efikasitet nga prokurorët e shtetit, në bashkëpunim të ngushtë me organet e tjera relevante.



Haxhiu takoi përfaqësueset e Forumit Ekonomik të Grave

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, zhvilloi të premten një takim me përfaqësueset e Forumit Ekonomik të Grave, i cili shërbeu si një mundësi e vlefshme për shkëmbimin e përvojave dhe

diskutimin e sfidave aktuale. Gjatë takimit, u diskutua për fuqizimin ekonomik të grave, barrierat që vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës, si dhe nevojën që politikat publike të përkthehen në mundësi

konkrete. Duke potencuar rëndësinë e bashkëpunimit me organizatat që angazhohen çdo ditë në këtë drejtim, kryetarja Haxhiu ritheksoi zotimin e saj që këto çështje të trajtohen nëpërmjet politikave konkrete.



NGA REZERVAT DERI TE TAKSAT: RRUGËT PËR STABILIZIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS NË KOSOVË

Rritja e vazhdueshme e çmimit të derivateve të naftës, si pasojë e konfliktit mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Iranit, po ndikon zinxhirin e çmimeve në të gjithë ekonominë e Kosovës, duke e bërë të papërbalueshme koston për qytetarët dhe bizneset. Çfarë rekomandojnë ekspertët për zbutjen e krizës?

PRISHTINË, 27 MARS - Konflikti mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Iranit ka shkaktuar probleme të mëdha në zinxhirin e furnizimit global me produkte të naftës, dhe i ka rritur ndjeshëm çmimet e karburanteve kudo në botë. Vetëm brenda pak javësh, çmimi i një litri dizel në pikat e karburanteve në Kosovë ka arritur deri në 1.79 euro, krahasuar me 1.33 euro sa ishte më 3 mars, tri ditë pas nisjes së sulmeve nga SHBA-ja dhe Izraeli kundër Iranit. Shtrenjtimi pothuajse i përditshëm i karburanteve në Kosovë, që ka rritur koston e jetesës dhe u ka shkaktuar bizneseve vështirësi në operim, ka bërë që vëmendja tani të drejtohet nga rezervat shtetërore të naftës. Por, sasia që Kosova e mban rezervë llogaritet se mjafton vetëm për rreth pesë ditë të konsumit. Megjithatë, ekspertët vlerësojnë se institucionet duhet ta lëshojnë atë në treg. “Shteti duhet të lëvizë, të lëvizë me aq sa ka, dhe të jetë transparent. Rezervat e shtetit kanë këtë sasi, kaq ditë mund t’i mbulojmë nevojat, dhe mbaroi puna”, thotë Shaban Halimi, ish-drejtor i Departamentit të Rezervave Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), në një bisedë me Radion Evropa e Lirë.

Si mund të shfrytëzohen rezervat e naftës?

Në bazë të Ligjit për Rezervat Shtetërore të Mallrave, shteti blen produkte esenciale: ushqime, barna dhe naftë. Këto produkte mund të përdoren në rast të çrregullimit të tregut, luftërave dhe katastrofave natyrore. Megjithatë, Halimi thotë se nëse rezervat përdoren në mënyrë të kufizuar dhe të orientuar, në mënyrë të duhur, shfrytëzimi i tyre mund të zgjatet deri në 10 ditë. “Qeveria mund t’i reduktojë, vetëm për institucionet shtetërore, shëndetësore, industrinë, ekonominë, autobusët, dhe të tjerët jo”, pohon ai. Vendndodhja e këtyre produkteve, sipas ligjit, mbetet sekret shtetëror, por ajo që dihet është se kontraktohen operatorët ekonomikë privatë për ruajtje, të cilët po ashtu mbikëqyrin vazhdimisht. MINTI-ja nuk ka dhënë përgjigje lidhur me sasinë e rezervave shtetërore të naftës, as nëse planifikohet aktivizimi i tyre në situatën aktuale.

Masat e Qeverisë dhe kërkesa për hapa të tjerë

Deri më tash, MINTI-ja ka caktuar vetëm fitimin maksimal të lejuar për shitjen me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës.



Sipas vendimit, marzha tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë do të jetë deri në 2 centë për litër, ndërsa me pakicë deri në 12 centë për litër. Por, kjo masë po duket e pamjaftueshme. Shoqata e Naftëtarëve të Kosovës, subjektet ekonomike dhe partitë opozitare kanë kërkuar që Qeveria të ulë tatimin e akcizës dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), pasi rritja e çmimit të derivateve të naftës po ndikon edhe në çmimet tjera. Ulja e tatimeve – akciza prej 0.36 euro dhe TVSH-ja prej 18 për qind të shumës së produktit – do ta lehtësonte barrën ndaj bizneseve dhe qytetarëve, thonë ata. Megjithatë, Kreu i Shoqatës së Naftëtarëve, Fadil Berjani, pohon për Radion Evropa e Lirë se në Qeveri “nuk e kanë parë të

arsyeshme të ulin akcizën dhe TVSH-në”. Ministria e Industrisë, Mimoza Kusari Lila, tha së voni se “TVSH-ja nuk ka qenë opsion, për shkak se është shumë problem të përcillet”.

Kosova e varur nga importi i naftës

Kosova nuk ka rafineri të veten të naftës, dhe furnizohet tërësisht nga importet. Nga muaji janar e deri më 23 mars të këtij viti, vendi importoi rreth 130 milionë euro naftë dhe benzinë. Të hyrat e shtetit nga akciza janë rreth 66 milionë euro, kurse nga TVSH-ja mbi 30 milionë. Vitin e kaluar, sipas të dhënave të Doganës se Kosovës, janë importuar rreth 530 milionë euro

naftë dhe benzinë. Për këto derivate, rreth 350 milionë euro janë tatim për akcizën, dhe mbi 157 milionë euro për TVSH-në. Furnizimet kryesore vijnë nga Gjermania, Hungaria, Greqia, Shqipëria dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, ndërsa një pjesë e konsiderueshme hyn përmes terminalit të Porto Romanos në Durrës. Kjo varësi strukturore e bën tregun e Kosovës jashtëzakonisht të ndjeshëm ndaj lëkundjeve globale. Derisa në Kosovë ende nuk ka ndonjë vendim nga institucionet për masa lehtësuese, shtetet e Ballkanit Perëndimor tashmë kanë ndërmarrë hapa të ndryshëm për frenimin e rritjes së çmimeve në pompat e karburanteve.

Ndalohet qarkullimi i mjeteve bujqësore në kryeqytet

Prishtinë, 17 mars- Bazuar në urdhëresën e kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, ndalohet qarkullimi i të gjitha mjeteve bujqësore në rrugët publike të zonave urbane të kryeqytetit. “Në kuadër të kësaj urdhërese, si mjete bujqësore

konsiderohen: motokultivatorët / multikultivatorët; makineritë e tjera të destinuara për punë bujqësore. Policia e Kosovës dhe Inspektorati Kryeqytetit do të ushtrjnë kontrole të vazhdueshme në terren, ndërsa ndaj çdo shkeljeje do të

ndërmerren masa në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ftojme të gjithë qytetarët që të respektojnë këtë urdhëresë, me qëllim të garantimit të rendit dhe sigurisë në komunikacion”, ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



45 milionë euro borxhe, KRU 'Prishtina': Shteti mbahet duke paguar shërbimet bazë

PRISHTINË, 27 MARS - Ujësjiellësi KRU "Prishtina" ka kërkuar përgjegjësi nga qytetarët për pagesat e faturave të ujit, duke potencuar se kompania është përballë një borxhi prej 45 milionë eurosh. Kjo kompani ka thënë se

pagesat me rregull janë kontribut i drejtpërdrejtë për një sistem funksional të shërbimit, prandaj bëri thirrje për veprim nga qytetarët. "Shteti mbahet duke paguar shërbimet bazë, siç është uji.

Megjithatë, përballë një borxhi prej 45 milionë eurosh për këtë shërbim jetik, lind pyetja: çfarë po bëjmë ne? A do të vazhdojmë të presim duarkryq, apo do të marrim përgjegjësi si qytetarë? Pagesa e rregullt e ujit nuk është

vetëm obligim, por edhe kontribut i drejtpërdrejtë për një sistem funksional, për furnizim të qëndrueshëm dhe për të ardhmen tonë të përbashkët. Është koha për veprim", është thënë në reagimin e KRU "Prishtina".



ODA AMERIKANE DHE KUSARI-LILA DISKUTOJNË REFORMAT PËR PËRMIRËSIMIN E KLIMËS SË BIZNESIT

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka organizuar një takim pune me ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit dhe përfaqësuesve të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

Sipas një njoftimi të OEAK-ut, gjatë takimit, Kusari-Lila ka prezantuar vizionin dhe programin e ministrisë, duke vënë theks të veçantë në prioritetet e politikave publike dhe agjendën legislative që synon avancimin e kornizës rregullative dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për të bërë biznes në Kosovë. Në këtë kuadër, ajo ka veçuar projektet kryesore, përfshirë transformimin e gjelbër të parqeve industriale dhe ndërtimin e parqeve të reja mbi parimet e ekonomisë qarkore. Një ndër objektivat strategjikë të



prezantuar ishte adresimi i deficitit tregtar, përmes mbrojtjes dhe promovimit të prodhimit vendor, përfshirë trajtimin preferencial në kontratat publike. Po ashtu, ministrja ka prezantuar ligjet prioritare që janë në proces apo në planifikim, si ligji për çmimet tavan në përgjigje ndaj situatave të krizës, ligji për inovacion dhe ndërmarrësi, si dhe ligji për pagesat e vonuara, në përputhje me agjendën e Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian. Diskutimet përfshinë gjithashtu ligje të tjera me ndikim të

drejtpërdrejtë në biznes, si ligji për tregtinë e brendshme, ligji për cilësinë e derivateve dhe ligji për shoqëritë tregtare. Në anën tjetër, përfaqësuesit e OEAK-ut kanë theksuar disa çështje prioritare për komunitetin e biznesit. Në këtë drejtim është kërkuar rishikimi i barrës fiskale për derivatet e naftës, në funksion të reflektimit të zhvillimeve aktuale në zinxhirët e furnizimit dhe shmangies së shtrembërimeve në treg. Po ashtu është kërkuar përfshirja në agjendën legislative

e një akti ligjor që adreson humbjet teknologjike, avullimin e mallrave dhe humbjet e tjera që ndodhin gjatë proceseve të operimit, me qëllim të rritjes së parashikueshmërisë dhe trajtimit të drejtë fiskal për bizneset. Një tjetër temë e ngritur ishte nevoja për mbështetje më të fuqishme të sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT), veçanërisht në drejtim të zhvillimit të fuqisë punëtore dhe adresimit të hendekut të aftësive, në përputhje me kërkesat në rritje të

tregut. Ministrja Kusari-Lila ka njoftuar edhe për procesin e transformimit të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), i cili përfshin mbështetjen për ndërmarrjet e reja, fuqizimin e grave dhe komuniteteve joshumicë, si dhe funksionalizimin e Fondit për Inovacion. Integrimi i arsimit dual profesional është theksuar gjithashtu si një komponent kyç për zhvillimin ekonomik afatgjatë. Gjatë diskutimit janë trajtuar edhe zhvillimet globale dhe rajonale, përfshirë menaxhimin e krizës së naftës dhe opsionet për Kosovën, hapat drejt zhvillimit të industrisë së mbrojtjes, thjeshtimin e kornizës ligjore për sektorin minerar, si dhe nevoja për avancim në fushën e kërkimit dhe testimit të zgjidhjeve teknologjike. Në përmbyllje, ministrja Kusari-Lila ka theksuar rëndësinë e përgjegjësisë sociale korporative dhe shprehu gatishmërinë e Qeverisë për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm dhe konstruktiv me sektorin privat.

LDK-JA SHKON NË KEDS, DORËZON DËSHMI PËR MASHTRIMET ME NJEHSORËT ELEKTRIKË

PRISHTINË, 27 MARS - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë dorëzuar dëshmi në zyrën e KEDS-it për njësorët elektrikë, të cilët sipas tyre po matin gabimisht kohën. Anëtarë i Kryesisë së LDK-së, Visar Azemi, ka thënë se kanë sjell dëshmi të mjaftueshme se qysh "KEDS-i po manipulon dhe vjedh qytetarët" duke mashtruar me kohën në njësorët elektrikë. "Qytetarët nuk po faturohen në bazë të periudhës së faturave me tarifa të shtrenjta dhe atë të lirë", ka thënë ai në deklarinimin për medie. Azemi kërkoi përgjegjësi institucionale nga qeveria Kurti, siç tha për këtë mashtrim. "Po i dorëzojmë këto dëshmi dhe për

t'ju treguar se faktet nuk gënjejnë. Tash do të hyjë dhe do të kërkojmë takim me menaxhmentin e KEDS-it dhe për t'ua shpjeguar këto fakte. Pra, nga kjo që kemi parë, e faktuar, është vepër penale, e këtu duhet me dhënë përgjegjësi. Prej këtu duhet për të shkuar edhe te zyrat e ZRRE-së, sepse nuk e kanë monitoruar implementimin e vendimeve për tarifat e qytetarëve të Kosovës, pra qysh duhet për ta paguar tarifën e shtrenjtë, kur ZRRE-ja ka thënë se prej orës 22:00 të natës fillon tarifa e lirë, pra ka thënë në orën 22:00, nuk ka thënë në orën 04:00 të mëngjesit, nuk ka thënë as në orën 06:00 të mëngjesit. E as kur



do KEDS-i e KESCO, por kanë thënë në orën 22:00. Nga aty duhet për të kërkuar përgjegjësi edhe te institucionet: Qeveria, ministria përgjegjëse, sepse kam dëgjuar që i kanë shkarkuar disa

zyrtarë, të cilët i kanë filluar hetimet pak më herët", ka thënë Azemi. Anëtarë i Kryesisë së LDK-së, Visar Azemi, në një konferencë për medie ka paraqitur fakte të

një skandali të madh të mashtrimit përmes njësorëve të energjisë elektrike. Nga verifikimi në terren i 884 njësorëve, rezultoi se 87 % e tyre e matin kohën gabimisht, duke faturuar energjinë me tarifa të shtrenjtë edhe gjatë konsumimit në orët e natës, kur tarifa është me të lirë. Ai ka theksuar se ky është rezultat i dështimit të qeverisë dhe ZRRE-së për ta monitoruar sistemin e llogaritjes së kohës në njësorët e energjisë elektrike. Azemi u bëri thirrje qytetarëve t'i kontrollojnë njësorët nëpër shtëpitë e tyre si dhe të mos heshtin, duke kërkuar kompensim dhe llogari nga institucionet për këtë skemë mashtrimi.

Shtyhet vendimi për daljen në treg të hapur të energjisë

PRISHTINË, 27 MARS - Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka njoftuar se është shtyrë procesi i vendimmarrjes për dalje në treg të hapur, derisa shtoi se kjo nuk pengon konsumatorët që të

ushtrojnë të drejtën e tyre për të dalë nga shërbimi universal që nga data 1 prill 2026. Sipas ZRRE-së, vendimi është shtyrë deri më 1 maj të këtij viti, dhe arsyetim i tyre është nevoja

për një analizë më të thelluar. "Konsumatorët që plotësojnë kushtet e nevojshme mund të vazhdojnë procedurat e kalimit në furnizuesin e zgjedhur sipas afateve dhe procedurave të

parashikuara. ZRRE do të vazhdojë të monitorojë procesin me kujdes dhe do të njoftojë publikun në kohë për çdo zhvillim të mëtejshëm", thuhet në njoftim.



E VËRTETA E KOSOVËS NUK ËSHTË VETËM ÇËSHTJE E NJË POPULLI POR PJESË E KUJTESËS SË PËRBASHKËT NJERËZORE

Vlerësim për librin “Kur heshtja flet” të autorit Ahmet Shala - profesor doktor, ministër e ambasador



Shkruan: Prof. Dr. Kudusi LAMA, gjeneral në pension

Libri “Kur heshtja flet” i autorit prof. Dr. Ahmet Shala, botuar në Prishtinë më 2025, paraqitet si një pamje që tejkalon kufijtë e zakonshëm të një rrëfimi personal apo dokumentar. Qysh në faqet e para, autori e vendos lexuesin përballë një tensioni të brendshëm të fuqishëm: “Brenda meje gumëzhinin tinguj e fjalë të pashkruara: zëra të shqetësuar, heshtje të rënda, pyetje pa përgjigje” (f. 9). Kjo nuk është vetëm një hyrje stilistike, por një deklaratë programatike e gjithë veprës – një shpërthim i brendshëm që kërkon të marrë formë në fjalë.

Në thelb, libri ndërtohet mbi një dualitet të qëndrueshëm: midis fjalës dhe heshtjes. Autori e koncepton veprën si një udhëtim që nuk kërkon zbulim estetik, por guxim moral për të rrëfyer. Siç shprehet vetë ai, “ka dhimbje që s’shërohen kurrë plotësisht, por mund të kthehen në dëshmi të dinjitetit” (f. 11). Kjo e shndërron tekstin në një akt dëshmie, ku rrëfimi nuk është qëllim në vetvete, por mjet për të mbajtur gjallë kujtesën dhe për të kundërshtuar harresën.

Në këtë kuptim, libri del përtej një përvoja individuale dhe merr përmasa kolektive. Ai është, sipas autorit, “më shumë se një rrëfim; është një përgjigje ndaj heshtjes” (f. 11), por edhe një kundërvënie ndaj një koncepti të rrezikshëm historik - atij që historia shkruhet vetëm nga të fuqishmit. Kështu, vepra vendoset në një linjë të qartë etike dhe intelektuale: të rikthejë zërin e atyre që janë lënë në periferi të rrëfimit zyrtar.

Një dimension i rëndësishëm i librit është ai i angazhimit moral dhe qytetar. Thirrja që autori ndien për të vepruar nuk është abstrakte, por konkrete dhe e personalizuar. Në momentin kur ai përmend mesazhin e Hashim Thaçit, ai e përkthen atë në një detyrim moral: për të “hapur derën e ngushtë” të padrejtësisë dhe për të dëshmuar solidaritet me ata që ndodhen brenda saj (f. 17). Kjo e kthen librin në një formë të veprimit përmes shkrimit – një përpjekje për të ndikuar realitetin përmes fjalës. Në këtë linjë, rrëfimi i udhëtimit drejt Hagës merr një dimension

simbolik. Ai nuk është thjesht një itinerar fizik, por një pelegrinazh shpirtëror dhe politik drejt një hapësire ku, sipas autorit, “padrejtësia ishte shndërruar në institucion” (f. 24). Ky formulim i fortë e vendos librin në një raport kritik me mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë, duke e parë atë jo si një strukturë neutrale, por si një realitet të kontestueshëm dhe të ngarkuar me implikime politike.

Një nga shtyllat kryesore të veprës është pikërisht ky qëndrim kritik ndaj drejtësisë selektive. Autori ngre pyetje të forta morale: për harresën e mijëra viktimave, për heshtjen ndaj krimeve të dokumentuara dhe për fokusin e njëanshëm të gjykit (f. 25–26). Në këtë prizëm, libri bëhet një akt akuze ndaj një sistemi që, sipas tij, ka devijuar nga misioni i tij themelor.

Por vlera e këtij libri nuk qëndron vetëm në kritikën që artikulon, por në mënyrën se si e ndërton këtë kritikë përmes përvojës personale dhe emocionale. Takimet me figurat kryesore të luftës dhe politikës, si Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, nuk paraqiten thjesht si episode biografike, por si momente reflektimi mbi drejtësinë, sakrificën dhe dinjitetin njerëzor.

Një element tjetër që e forcon këtë dimension është prania e zërit ndërkombëtar, e përfaqësuar përmes figurës së “Tony-it”, kongresmeni amerikan i cili e përjeton këtë realitet si një “të vërtetë të hidhur” (f.41).

Kjo e zgjeron perspektivën e librit dhe e vendos çështjen në një kontekst më të gjerë, përtej kufijve kombëtarë.

Në vijim libri ndërtohet mbi një ndjenjë të fortë përgjegjësie morale. Autori e sheh veten përballë një zgjedhjeje: “jo rrugën më të lehtë, por rrugën më të drejtë” (f. 46). Kjo zgjedhje përkthehet në një angazhim të qartë për të mos heshtur, për të dëshmuar dhe për të mbajtur gjallë zërin e atyre që nuk mund të flasin (f. 47). Duke e paraqitur kështu librin jo thjesht një libër kujtimesh apo refleksionesh. Por si një tekst të ndërgjegjes, një akt të guximit qytetar dhe një përpjekje për të kthyer heshtjen në zë - një zë që sfidon harresën dhe kërkon drejtësi.

Më tej autori e thellon ndjeshëm dimensionin shpirtëror, etik dhe historik të rrëfimit, duke e shndërruar librin nga një dëshmi personale në një reflektim të gjerë mbi besimin, sakrificën dhe drejtësinë. Në këtë segment, teksti merr një karakter më universal.

Një nga shtyllat themelore të përmbajtjes së librit është përvoja e besimit. Autori e rikthen lexuesin në një marrëdhënie intime me

traditën dhe edukimin familjar, duke e përshkruar lutjen jo thjesht si një praktikë fetare, por si një proces të “akordimit dhe sinkronizimit të ndjenjave, energjisë e përcaktimeve përtej fuqisë njerëzore” (f. 93–94). Kjo e vendos besimin në qendër të ekzistencës së tij, jo si dogmë, por si përvojë e jetuar, si një burim i qëndrueshëm force dhe ekuilibri. Ritual i lutjes, i trashëguar nga nëna, shndërrohet në një metaforë të vazhdimësisë shpirtërore dhe identitare. Edhe pse fillimisht mekanik, ai evoluon në një vetëdije të thellë, duke reflektuar rrugëtimin e vetë autorit nga tradita drejt kuptimit. Kjo lidhje midis besimit dhe jetës së përditshme krijon një dimension të veçantë të tekstit, ku përvoja individuale bëhet universale dhe e komunikueshme për çdo lexues.



Në të njëjtën kohë, libri ndërton një lidhje të fortë midis lutjes dhe veprimit. Autori nuk qëndron në një spiritualitet pasiv; përkundrazi, ai e shndërron lutjen në angazhim konkret. Siç thekson ai, vizita në Hagë nuk ishte “për të parë, por për të dëshmuar” (f. 47), ndërsa më tej ajo merr formën e një misioni për ata “që nuk kishin zë” (f. 105). Kjo është një nga pikat më të forta të veprës: ndërthurja organike e besimit me përgjegjësinë qytetare. Në këtë kontekst, autori e shndërron përvojën e tij në një akt solidariteti të thellë njerëzor. Ai dhe bashkudhëtarët e tij përfaqësojnë një bashkësi ndërgjegjesh që veprojnë në emër të drejtësisë dhe dashurisë, duke synuar të bëhen “zëri i tyre për botën e shurdhër” (f. 105). Ky formulim përmbledh një nga idetë kyçe të librit: heshtja nuk është vetëm mungesë e fjalës, por shpesh edhe mungesë e vullnetit për të dëgjuar.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i kësaj pjese është reflektimi mbi sakrificën. Autori e vendos përballë lexuesit një kontrast të fortë midis

jetës së zakonshme dhe sakrificës së atyre që zgjedhën luftën për liri. Përshkrimi i luftëtarëve që lanë gjithçka pas dhe u nisën drejt maleve “nëpër shi, acar e breshëri plumbash” (f. 122–123) është një nga momentet më të fuqishme emocionale të tekstit. Kjo nuk është vetëm një kujtesë historike, por një thirrje për reflektim moral mbi çmimin e lirisë.

Në këtë linjë, autori sfidon edhe një fenomen të thellë kulturor: prirjen për të nderuar vetëm heronjtë e rënë. Ai ngre një çështje thelbësore për ndërgjegjen kolektive shqiptare, duke kërkuar që respekti dhe mirënjohja të shtrihen edhe ndaj atyre që janë ende gjallë dhe që mbajnë mbi supë barrën e historisë. Në këtë kuadër, figurat si Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi paraqiten si vazhdimësi e një

tradite të gjatë rezistence dhe sakrifice.

Një nga kulmet analitike të librit është kritika e drejtpërdrejtë ndaj konceptit të drejtësisë ndërkombëtare. Autori ngre pyetje retorike të forta mbi natyrën selektive të drejtësisë dhe mbi mundësinë që ajo të përdoret si instrument politik (f. 151–152). Në këtë kontekst, ai argumenton se nuk po gjykohej thjesht dhuna, por vetë identiteti dhe historia e një populli.

Kjo qasje e vendos librin në një debat të gjerë teorik dhe historik mbi drejtësinë tranzicionale dhe ecurinë historike. Autori e sheh procesin gjyqësor jo vetëm si një çështje juridike, por si një akt që do të ndikojë mënyrën se si do të shkruhet historia në të ardhmen. “Ajo që nuk shkruhet sot, nesër do të harrohet” (f. 153) – ky pohim përmbledh thelbin e shqetësimit të tij.

Në këtë prizëm, heshtja merr një kuptim të ri: ajo nuk është më vetëm një gjendje individuale, por një fenomen kolektiv me pasoja të

rënda historike. Heshtja, sipas autorit, mund të bëhet bashkëfajësi, mund të shndërrohet në një mekanizëm që lejon deformimin e së vërtetës dhe fshirjen e kujtesës.

Për të mbështetur këtë argument, autori i referohet një sërë burimesh ndërkombëtare, si raportet e Human Rights Watch dhe Amnesty International, si dhe dokumenteve të tjera që dëshmojnë për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë (f. 167). Kjo e forcon dimensionin dokumentar të veprës dhe i jep asaj një bazë të qëndrueshme faktike. Kështu gradualisht, mund të thuhet se “Kur heshtja flet” arrin të ndërtojë një strukturë të fuqishme ku ndërthuren tre shtylla themelore: besimi, kujtesa dhe drejtësia. Libri kështu nuk është vetëm një rrëfim personal, por një akt i vetëdijes historike dhe një thirrje për përgjegjësi kolektive.

Duke lexuar më tej konstatohet se autori e zhvendos vëmendjen nga përjetimi personal dhe reflektimi shpirtëror drejt një analize të drejtpërdrejtë, të thellë dhe të pa kompromis mbi drejtësinë ndërkombëtare, rrëfimin historik dhe luftën e vazhdueshme për të vërtetën. Ku shihet se gradualisht arrijmë në kulminim ideor të librit - aty ku heshtja nuk është më vetëm përjetim, por bëhet objekt akuze dhe thirrje për reagim.

Autori ngre një varg pyetjesh thelbësore që nuk janë thjesht retorike, por goditëse në esencën e ndërgjegjes kolektive: pse krimet mbetën pa autorë, pse masakrat u relativizuan dhe pse dokumentet ndërkombëtare u shpërfillën? (167 - 168) Këto pyetje nuk kërkojnë vetëm përgjigje historike, por edhe përgjegjësi morale. Në këtë kuptim, teksti merr dimensionin e një aktakuze të heshtur ndaj një rendi ndërkombëtar që, sipas autorit, ka zgjedhur shpesh stabilitetin politik mbi drejtësinë. Autori argumenton se në këtë “pazar makabër”, drejtësia është relativizuar dhe viktimat janë trajtuar si “kosto e parëndësishme”. Ky formulim është i fortë, por pikërisht kjo forcë e bën tekstin të ndikojë thellë: ai nuk përpigjet të zbusë realitetin, por ta ekspozojë atë në mënyrë të zhveshur. Këtu qëndron një nga vlerat kryesore të veprës - guximi për të artikuluar atë që shpesh mendohet, por rrallë thuhet publikisht.

Në vijim, autori e thellon argumentin duke e parë krijimin e Gjykatës Speciale jo si një instrument të drejtësisë së paanshme, por si një produkt të presioneve politike ndërkombëtare. Ai e quan atë një gjykatë “jo nga dhe për popullin që kërkonte drejtësi”, por të imponuar nga interesa të jashtme.

Një nga momentet më të fuqishme të kësaj vepre është përshkrimi i sakrificës së luftëtarëve të UÇK-së.

Autori rikthen në kujtesë rrugëtimin e tyre përmes Bjeshkëve të Nemuna, përballjen me minat, pritrat dhe rrezikun e vazhdueshëm. Ky përshkrim nuk është thjesht historik; ai është simbolik. Ai përfaqëson një përballje ekzistenciale midis jetës dhe vdekjes, midis robërisë dhe lirisë. Përmes këtij imazhi, autori ndërton një kontrast të fortë me realitetin e sotëm, ku, sipas tij, ata që dikur rrezikuan gjithçka për lirinë, sot gjenden të gjykuar në një realitet të shtrembëruar.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i kësaj vepre është analiza e luftës së re – luftës së mashtrimeve. Autori argumenton se pas përfundimit të luftës fizike, filloi një luftë tjetër, më e sofistikuar: ajo e propagandës. Kjo luftë nuk zhvillohet më me armë, por me dokumente, raporte, media dhe institucione. Sipas tij, makineria propagandistike serbo-ruse ka synuar të zhbëjë legjitimitetin moral të luftës çlirimtare dhe ta paraqesë atë si një ndërmarrje kriminale.

Në këtë kontekst, përmendja e figurave dhe raporteve ndërkombëtare, si ai i Dick Marty-t, nuk është rastësore. Ajo shërben për të ilustruar mënyrën se si, sipas autorit, historia e fabrikuar mund të institucionalizohet dhe të marrë formë zyrtare. Kjo është një nga idetë më të forta të librit: se e vërteta nuk është gjithmonë ajo që dokumentohet, por ajo që mbrohet dhe dëshmohet vazhdimisht.

Autori shkon edhe më tej, duke e lidhur këtë fenomen me një traditë më të gjerë të propagandës shtetërore, duke përmendur edhe konceptin e “gënjeshtrës si interes nacional”. (190) Në këtë mënyrë, ai e vendos përballjen shqiptare jo vetëm në një kontekst lokal, por në një dimension më të gjerë historik dhe gjeopolitik.

Një nga reflektimet më të goditura është dallimi që autori bën midis dy llojeve të heshtjes: heshtjes nga pamundësia dhe heshtjes nga qëllimi. Ky dallim është thelbësor për të kuptuar mesazhin e librit. Heshtja e parë është tragjike, ndërsa e dyta është e rrezikshme. Dhe pikërisht kjo e dyta, sipas autorit, ka kontribuar në deformimin e së vërtetës dhe në padrejtësitë e sotme.

Në këtë pikë, libri merr një dimension të qartë etik: ai nuk është më vetëm një rrëfim apo analizë, por një thirrje për përgjegjësi. Autori thekson se përballë një strategjie që synon të barazojë viktimën me agresorin, heshtja nuk është më neutralitet, por bashkëfajësi.

Kulmi arrihet në mesazhin se fjala është arma e fundit dhe më e fuqishme. Kjo është një tezë që përshkon gjithë librin, por që këtu artikullohet me qartësi të plotë. Në një botë ku historitë mund të manipulohen, fjala e vërtetë bëhet mjeti i vetëm për të ruajtur dinjitetin historik dhe moral.

Për këtë, autori nuk kursen as kritikën ndaj vetes kolektive. Ai flet për dështimin e një pjese të lidërshit shqiptar për të dalluar miqtë e vërtetë dhe për të demaskuar propagandën. Ky vetëreflektim e bën tekstin më të besueshëm dhe më të thellë, sepse nuk mbetet në nivelin e akuzës ndaj të tjerëve, por përfshin edhe

përgjegjësinë e brendshme.

Kështu, brendësia e “Kur heshtja flet” shndërrohet në një manifest të fuqishëm për kujtesën, të vërtetën dhe drejtësinë. Ajo nuk synon të japë përgjigje përfundimtare, por të nxisë mendim kritik dhe ndërgjegjësim. Gjithnjë duke forcuar e zgjeruar aspektin argumentues dhe emocional. Duke e ngritur veprën nga një rrëfim personal në një tekst me peshë publike dhe historike, duke e bërë atë jo vetëm një dëshmi të kohës, por edhe një thirrje të qartë: të mos heshtim më.

Autori e çon analizën e tij drejt një thellësie edhe më të madhe, duke e përqendruar diskursin në tri shtylla themelore: propagandën si armë strategjike, drejtësinë si instrument i deformuar dhe kujtesën si mjet mbijetese kombëtare. Prej nga shihet pjekuria e plotë e mendimit të autorit, ku përvoja personale, reflektimi filozofik dhe analiza politike ndërthuren në një rrëfim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm.

Autori e trajton propagandën kundërshtqiptare serbo-ruse jo si një fenomen sporadik, por si një strategji të koordinuar dhe afatgjatë. Ai e përshkruan atë si një mekanizëm që nuk synon vetëm deformimin e realitetit, por edhe zhdukjen e vetë kujtesës së rezistencës. Kjo është një ide thelbësore: nuk luftohet më vetëm e tashmja, por edhe e kaluara. Lufta për interpretimin e historisë bëhet kështu një front po aq i rëndësishëm sa edhe vetë lufta fizike.

Në këtë kuadër, autori argumenton se propaganda nuk është ndalur te demonizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por është zgjeruar drejt delegjitimitimit të gjithë strukturës shtetërore të Kosovës. Kjo qasje e bën analizën më gjithëpërfshirëse dhe e vendos librin në një kontekst më të gjerë politik dhe historik. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një përpjekje për të njollësuar të kaluarën, por me një projekt për të dobësuar të tashmen dhe për të kontrolluar të ardhmen.

Një nga idetë më të fuqishme të kësaj vepre është koncepti i drejtësisë së deformuar. Autori thekson se kur drejtësia përdoret për të ndëshkuar ata që luftuan për mbrojtje dhe jo ata që kryen krime, ajo humbet thelbin e saj. Kjo nuk është thjesht një kritikë ndaj një institucioni të caktuar, por një refleksim më i gjerë mbi rrezikun e instrumentalizimit të drejtësisë në funksion të interesave politike.

Në këtë kontekst, ai e përkufizon këtë fenomen si një “barazi e rreme” – një përpjekje për të barazuar viktimën me agresorin. Ky formulim është ndër më të goditurit në të gjithë veprën, sepse sintetizon në mënyrë të përkryer shqetësimin kryesor të autorit: zhbërjen morale të historisë.

Një tjetër dimension i rëndësishëm është trajtimi i figurave të luftës dhe i gjeneratës çlirimtare. Autori i sheh ata jo vetëm si pjesë të së kaluarës, por si një “busull” për të ardhmen. Kjo metaforë është domethënëse, sepse e zhvendos fokusin nga glorifikimi statik drejt funksionit orientues të historisë. Kjo gjeneratë nuk duhet vetëm të nderohet, por të kuptohet dhe të përvetësohet si model vlerash.

Në një nga pasazhet më origjinale, autori e përshkruan këtë gjeneratë si një “recetë” kundër harresës. Kjo

metaforë, ndonëse e pazakontë në diskursin akademik, është shumë efektive në planin retorik. Ajo sugjeron se kujtesa nuk është vetëm një akt emocional, por një proces aktiv që kërkon përvetësim dhe përkushtim. Edhe nëse kjo “recetë” mund të mos jetë gjithmonë e pëlqyeshme për të gjithë, ajo mbetet, sipas autorit, e domosdoshme për shëndetin moral të shoqërisë.

Autori paralajmëron me forcë për rrezikun e manipulimit përmes propagandave të sofistikuara. Ai vë në dukje se këto mekanizma nuk veprojnë më në mënyrë të drejtpërdrejtë, por përmes një procesi gradual që e bën të zezën të duket gri dhe të bardhën të duket e zezë. Kjo analizë është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e sotëm, ku informacioni është i bollshëm, por e vërteta shpesh e paqartë.

Ashtu sikurse, autori nuk harron të theksojë edhe dimensionin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Ai e përshkruan historinë e saj jo vetëm si një histori lufte, por si një dëshmi të solidaritetit ndërkombëtar dhe të ndërgjegjes njerëzore. Ky është një moment balancues në tekst, ku kritika ndaj padrejtësive nuk e errëson plotësisht rolin pozitiv të aleancave dhe mbështetjes ndërkombëtare.

Një nga mesazhet më të qarta dhe më të forta të kësaj vepre është ideja se liria nuk është një trofe, por një amanet. Ky formulim e ngre diskutimin në një nivel etik dhe filozofik. Liria kërkon kujdes, kujtesë dhe veprim. Pa këto elemente, ajo rrezikon të zbrazet nga kuptimi i saj.

Në vijim, autori rikthehet te simbolika e burgut në Hagë, duke e përshkruar atë jo vetëm si një hapësirë fizike, por si një metaforë të një heshtjeje të organizuar. Kjo heshtje, sipas tij, është më e rrezikshme se vetë padrejtësia, sepse ajo e maskon atë. Referenca ndaj Ismail Kadares e thellon këtë ide, duke e lidhur atë me një traditë më të gjerë letrare dhe filozofike mbi heshtjen dhe të vërtetën.

Një nga pamjet më të bukura dhe më domethënëse të kësaj vepre është reflektimi mbi mënyrën se si kombi shqiptar e ka ruajtur historinë e tij. Përmes gojëdhënave, këngëve, tregimeve dhe kujtesës kolektive, e vërteta ka mbijetuar edhe në kushtet më të vështira. Ky është një mesazh i fuqishëm: edhe kur institucionet dështojnë, kujtesa popullore mund të mbetet një bastion i së vërtetës.

Në thelb, nëpër faqet e këtij libri paraqitet një thirrje për vetëdije dhe përgjegjësi. Duke qartësuar se ajo nuk mjaftohet me analizën e së kaluarës, por kërkon angazhim në të tashmen dhe vigjilencë për të ardhmen.

Në pjesën përmbyllëse të veprës së tij, Dr. Ahmet Shala e ngre reflektimin nga një përvojë personale dhe kombëtare në një dimension universal, duke e vendosur librin në një horizont më të gjerë moral dhe historik. Ai nuk flet më vetëm për Kosovën si një rast i izoluar, por si një provë për vetë ndërgjegjen e njerëzimit. Në këtë kuptim, libri kapërcen kufijtë e një rrëfimi dokumentar dhe bëhet një tekst me peshë filozofike, etike dhe qytetëruese.

Autori shtron një tezë themelore: e

vërteta e Kosovës nuk është vetëm çështje e një populli, por pjesë e kujtesës së përbashkët njerëzore. Ai e koncepton këtë të vërtetë si një amanet që duhet ruajtur, transmetuar dhe mbrojtur nga harresa dhe deformimi. Kjo ide përmbën boshtin moral të gjithë veprës dhe e vendos lexuesin përballë një përgjegjësie që nuk është thjesht historike, por edhe shpirtërore.

Në mënyrë të veçantë, autori e trajton çështjen e Hagës si një nyje ku përplasen drejtësia, politika dhe ndërgjegjja. Ai argumenton se ajo që ndodh në Hagë nuk është vetëm proces juridik, por një moment vendimtar për mënyrën se si do të shkruhet historia. Në këtë kuptim, gjykimi i individëve shndërrohet në gjykim të kujtesës kolektive dhe të vetë shkrimit të historisë së një populli e kombi.

Një nga figurat më të fuqishme që përdor autori është ajo e së vërtetës si një forcë e pashkatërrueshme. Ai e përshkruan atë si një element që mund të shtypet, të vonohet, madje edhe të deformohet përkohësisht, por që në fund gjithmonë depërton dhe del në sipërfaqe. Kjo metaforë i jep veprës një dimension shprese dhe qëndrueshmërie, duke e balancuar tonin kritik me një besim të thellë në triumfin e së drejtës.

E në vijim, autori artikulon një nga mesazhet më të forta të librit: heshtja nuk është neutralitet, por bashkëfajësi. Ai paralajmëron se të heshtësh për padrejtësinë do të thotë të heqësh dorë nga vetë identiteti historik dhe moral. Kjo ide shndërrohet në një thirrje të drejtpërdrejtë për angazhim, duke e kthyer librin në një manifest të ndërgjegjes qytetare.

Një dimension tjetër i rëndësishëm është reflektimi mbi raportin midis të vërtetës dhe guximit. Autori e shpjegon se pranimi i së vërtetës nuk është vetëm një akt intelektual, por një akt shpirtëror që kërkon empati dhe ndjeshmëri. Kjo e zhvendos debatin nga fusha e fakteve në atë të etikës, duke e bërë librin jo vetëm një dëshmi, por edhe një apel për humanizëm.

Në kulmin e këtij reflektimi, autori arrin në një formulim të qartë dhe të drejtpërdrejtë: në Hagë nuk po gjykohen vetëm individë, por vetë historia e një populli dhe ndërgjegjja e botës. Ky është një përfundim i fortë, që i jep veprës një dimension dramatik dhe universal, duke e bërë atë të rezonojë përtej kontekstit shqiptar. Një vend të veçantë në këtë vepër zë edhe mesazhi për brezat e rinj. Autori i sheh ata jo thjesht si trashëgimtarë të historisë, por si krijues aktivë të saj. Ai i fton të ndërtojnë paqe pa harruar të kaluarën, të kërkojnë drejtësi pa rënë në urrejtje dhe të ruajnë balancën midis kujtesës dhe vizionit për të ardhmen. Ky është një mesazh i pjekur dhe i domosdoshëm, që i jep veprës një dimension edukativ dhe orientues. Në këtë kontekst, liria nuk paraqitet si një arritje e përfunduar, por si një proces që kërkon kujdes të vazhdueshëm. Ajo është një barrë morale dhe historike që duhet mbajtur me vetëdije dhe përkushtim. Kjo qasje e zhvendos fokusin nga glorifikimi i së kaluarës drejt përgjegjësisë për të ardhmen. Autori përdor gjithashtu një

krahasim të fortë historik për të ilustruar rrezikun e deformimit të drejtësisë, duke kujtuar se edhe regjime të tjera në histori kanë përdorur ligjin për të justifikuar padrejtësinë. Ky paralelizëm i jep argumentit të tij një dimension universal dhe e vendos çështjen e Kosovës në një kontekst më të gjerë historik.

Në fund, autori arrin në një përfundim të prerë: drejtësia që nuk është e barabartë, nuk është drejtësi. Nëse ajo zbatohet selektivisht dhe në mënyrë të njëanshme, ajo shndërrohet në një instrument politik dhe jo në një vlerë universale. Ky është një konstatim i fortë, që sintetizon gjithë kritikën e veprës.

Në përfundim mund të them se “Kur heshtja flet” është një vepër që ndërthur rrëfim personal, reflektimin filozofik dhe analizën historike në një strukturë të vetme dhe të qëndrueshme. Ajo nuk është thjesht një libër kujtimesh apo një reagim emocional, por një tekst i ndërtuar me vetëdije të lartë intelektuale dhe me një qëllim të qartë: të mbrojë të vërtetën nga harresa dhe deformimi.

Vlera kryesore e librit qëndron në aftësinë e tij për ta kthyer heshtjen në fjalë dhe dhimbjen në dëshmi. Autori arrin të krijojë një rrëfenjë që është njëkohësisht personale dhe kolektive, duke e bërë lexuesin pjesë të një përvoje që tejkalon individin.

Nga pikëpamja stilistike, vepra karakterizohet nga një gjuhë e ngarkuar emocionalisht, por e kontrolluar, me figura të forta dhe ritëm të qëndrueshëm. Ajo arrin të ruajë ekuilibrin midis patosit dhe argumentit, duke mos rënë në retorikë të zbrazët.


Në planin tematik, libri trajton çështje të mëdha si drejtësia, e vërteta, kujtesa, propaganda dhe përgjegjësia morale. Këto tema nuk trajtohen në mënyrë abstrakte, por të lidhura ngushtë me përvojën konkrete historike të Kosovës, duke i dhënë veprës autenticitet dhe peshë.

Në fund, kjo vepër mbetet një thirrje e fuqishme: të mos harrojmë, të mos heshtim dhe të mos lejojmë që e vërteta të zëvendësohet nga historitë e rreme. Ajo është një kujtesë se historia nuk është vetëm ajo që ka ndodhur, por edhe ajo që ne zgjedhim të tregojmë për të. Dhe pikërisht këtu qëndron fuqia e saj më e madhe: në bindjen se fjala, kur është e vërtetë, ka fuqinë të përballojë edhe heshtjen më të rëndë.

Në këtë mënyrë, vepra e Ahmet Shala afirmohet si një tekst që nuk kërkon vetëm të lexohet, por të reflektohet, të diskutohet dhe mbi të gjitha - të dëgjohet. Sepse, në fund, siç sugjeron vetë titulli, janë pikërisht momentet kur heshtja flet ato që kërkojnë më shumë vëmendje nga ne.

Në përmbyllje, mund të thuhet se kjo vepër paraqitet si një punim me peshë të veçantë jo vetëm letrare, por edhe historike e politike. Ajo i jep lexuesit jo vetëm njohuri, por edhe një ndjenjë detyrimi: për të kujtuar, për të reflektuar dhe mbi të gjitha, për të mos heshtur.

Tiranë më 24 mars 2026



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Shqipëria eliminohet nga Polonia, Sylvinho mund të largohet nga kombëtarja

TIRANË, 27 MARS - Ëndrra për në Botëror është shuar përfundimisht. Shqipëria, të është mposhtur 2:1 nga Polonia në gjysmëfinalen e "play-off" për kualifikim në Kupën e Botës për t'i dhënë fund shpresave që të jetë pjesëmarrëse në këtë ngjarje të madhe. Shqipëria

ishte në epërsi prej pjesës së parë me golin e Arbër Hoxhës, por në pjesën e dytë Polonia ka shënuar dy herë brenda dhjetë minutave me Robert Lewandowskin dhe Piotr Zielinski për ta fituar ndeshjen. Humbja e Shqipërisë në Varshavë, mund të shënojë

edhe fundit e kapitullit të selektorit Sylvinho në krye të "kuqezinjve". Sylvinho ka kontratë me FShF-në deri në muajin korrik, të cilën e ka rinovuar muaj me parë për ndeshjet e rëndësishme të "play-off"-it për kualifikim në Botëror dhe është thënë se e

ardhmja e tij do të vendoset pas duelit me Ukrainën. Shqipëria, të martën mbrëma përballet me Ukrainën, e cila gjithashtu është mposhtur në gjysmëfinale të "play-off"-it nga Suedia, në një ndeshje që do të ketë karakter të miqësorës.



KOSOVA SHKRUAN HISTORI, KALON NË FINALE TË "PLAY-OFF"-IT PËR BOTËRORIN 2026

Kombëtarja e Kosovës ka shënuar fitore historike kundër Sllovakisë, duke u kualifikuar në finalen e "play-off"-it për Kupën e Botës 2026. Pas kësaj fitoreje, Kosova do të përballet me Turqinë më 31 mars në stadiumin "Fadil Vokrri". Fituesi i kësaj përballjeje do të sigurojë një vend në Kupën e Botës, që këtë vit organizohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada




BRATISLAVË, 27 MARS - Kombëtarja e Kosovës ka arritur suksesin më të madh në historinë e saj, duke u kualifikuar në finalen e "play-off"-it për Kupën e Botës 2026, pas një ndeshjeje spektakolare në Bratislavë. "Dardanët" kanë triumfuar ndaj Sllovakisë me rezultat 4:3, në një përballje dramatike dhe plot emocione, duke dëshmuar karakter të jashtëzakonshëm dhe shpirt të pathyeshëm. Ndeshja ka nisur në mënyrë jo të favorshme për Kosovën, që ka pësuar gol që në minutën e 6-të pas një ndërprerjeje, kur Martin Valjent ka realizuar me kokë. Megjithatë, reagimi i skuadrës sonë ishte i menjëhershëm. Në minutën e 21-të, Veldin Hoxha ka barazuar rezultat pas asistimit të Mërgim Vojvodës. Në fund të pjesës së parë, vendasit kanë rikthyer epërsinë me golin e Lukas Haraslin nga gjuajtja e lirë, duke e mbyllur pjesën e

parë me rezultat 2:1. Pjesa e dytë ka nisur furishëm për Kosovën. Vetëm dy minuta pas rifillimit, Fisnik Asllani ka barazuar shifrat në 2:2 me një goditje me kokë. Dominimi i "Dardanëve" ka vazhduar dhe në minutën e 60-të, Florent Muslija ka realizuar një supergol nga gjuajtja e lirë për epërsinë 3:2. Kosova nuk është ndalur. Në minutën e 72-të, Kreshnik Hajrizi ka shënuar për 4:2, duke afruar edhe më shumë skuadrën drejt fitores historike. Edhe pse sllovakët kanë ngushtuar rezultat në minutën e 94-të me golin e David Strelec, kjo nuk e ka zbehur festën e madhe të Kosovës. Me këtë fitore, Kosova ka siguruar

kalimin në finalen e "play-off"-it, ku do të përballet me Turqinë më 31 mars në stadiumin "Fadil Vokrri". Fituesi i kësaj përballjeje do të sigurojë një vend në Kupën e Botës 2026, që këtë vit organizohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Meksikë dhe Kanada. Kosova është vetëm një hap larg historisë së madhe. Për këtë fitore, liderët institucionalë dhe partiakë kanë përgëzuar lojtarët e Kosovës.

Fitorja historike e "Dardanëve", Ademi: Kosova nuk dorëzohet kurrë!

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, e ka quajtur historike fitoren e "Dardanëve" ndaj Sllovakisë, duke siguruar kështu finalen e "play-off"-it që do të zhvillohet më 31 mars përballë Turqisë. Përmes një postimi në "Facebook", Ademi e ka cilësuar këtë fitore si një nga ndeshjet më të rëndësishme në historinë e futbollit të Kosovës. "Dardanët tanë triumfuan në gjysmëfinalen e 'play-off'-it për Kupën e Botës 2026, duke bërë një hap gjigant drejt ëndrrës sonë të madhe. Kjo nuk ishte vetëm një ndeshje... ishte dëshmi e karakterit, e sakrificës dhe e shpirtit të pathyeshëm që e mban gjallë këtë Kombëtare", ka shkruar Ademi. Ndër të tjera, i pari i FFK-së ka thënë se "Dardanët" nuk dorëzohen kurrë, ndërsa i uroi të njëjtët për triumfin e arritur. "Në një atmosferë të shkëlqyeshme nga tifozët tanë, 'gladiatorët dardanë'



treguan se Kosova nuk dorëzohet kurrë! Urime futbollistëve, stafit dhe të gjithë tifozëve që ishin zemra e kësaj fitoreje, në stadium dhe kudo në botë. Tani vetëm një hap larg historisë... Faleminderit secilit tifozë që ishte i pranishëm në stadium dhe na përkrahi fuqishëm dhe të gjithë popullit në Kosovë e Diasporë që na qëndrojnë afër. Vazhdojmë bashkë, me besim të plotë drejt finales!", ka përfunduar Ademi.

Interesim i madh për ndeshjen Kosovë-Turqi

PRISHTINË, 27 MARS - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ka shprehur mirënjohje ndaj të gjithë atyre që besojnë dhe e mbështesin pandërprerë Kombëtaren. Përkrahja e jashtëzakonshme nga qytetarët, si në vend ashtu edhe në diasporë, përfshirë edhe numrin e madh të atyre që udhëtuan drejt Sllovakisë, sipas FFK-së, është dëshmi e lidhjes së fortë dhe të përhershme me fanellën "dardane".

Duke qenë se interesi për ndeshjen finale Kosovë - Turqi tejkalon kapacitetin e stadiumit,

është bërë me dije se FFK-ja, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës do të organizojë aktivitete të veçanta në kryeqytet, ku përmes ekraneve gjigante qytetarët do të kenë mundësinë ta ndjekin këtë përballje historike. "Qëllimi është krijimi i një atmosfere gjithëpërfshirëse, ku secili tifoz të ndjejë emocionin dhe krenarinë e përkrahjes ndaj Kombëtares së Kosovës. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që siguruan biletat për këtë ndeshje, edhe në një fazë kur ende nuk ishte e

konfirmuar nëse do të bëhej fjalë për një finale apo një ndeshje miqësore, një dëshmi kjo e besimit dhe dashurisë së madhe ndaj ekipit 'dardan'. Në të njëjtën kohë, shprehim keqardhje për pamundësinë që t'i përgjigjemi interesimit të jashtëzakonshëm të tifozëve për të qenë të pranishëm në stadiumin 'Fadil Vokrri', duke pasur parasysh kapacitetin e kufizuar të tij. Andaj, edhe një herë njoftojmë opinionin publik se nuk ka më asnjë biletë në dispozicion. Një pjesë e tyre janë të rezervuara për tifozët

mysafirë, sipas obligimeve ndërkombëtare, si dhe për partnerët, ku edhe këtë herë numri ka qenë tejte i kufizuar", ka njoftuar FFK-ja.

Federata ka theksuar e është e obliguar t'u përmbahet rregulloreve të UEFA-s dhe FIFA-s, të cilat nuk lejojnë tejkalimin e kapacitetit të regjistruar zyrtarisht të stadiumit, prandaj nuk ekziston asnjë mundësi për tejkalim të numrit të përcaktuar të biletave. "Me besimin dhe shpresën se kjo ndeshje do të kurorëzohet me sukses, synimi ynë i



përbashkët mbetet që festa e futbollit të shtrihet në çdo cep të vendit. Prandaj, ftojme qytetarët që mbështetjen për djemtë dardanë ta japin nga sheshet, por edhe nga shtëpitë e tyre. Përkrahja e tyre ndjehet kudo ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët. Të bashkuar për suksesin historik! Forca Kosovë!", ka njoftuar FFK-ja.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Data Connection” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811486407 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Data Connection” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811486407 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Data Connection” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811486407 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Eldison Kryeziu shpall te pa vlefshme diplomën e shkollës se mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash.

- “Kika Bio Farm” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330406105.

- Fatmir Gashi shpall të pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Mikel Oroshi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Qendrim Ahmetaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Reis Miftari shpall të pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Berat Mazrek shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore “Ana Dollu” Mamush.

- “Joes Caffè” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810174847 Fushë Kosovë.

- Alban Sahatçiu B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr:3300354423.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

- Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

- Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

